

Dr. Vehbetu Zuhejli

Kundërshtimi dhe favorizimi i mendimit

XIX

Pjesë e shkëputur nga “Usuli fikhu islam”

Autori:

Dr. Vehbetu Zuhejli

Përktheu:

Dr. Musli Vërbani

Titulli:

Kundërshtimi dhe favorizimi i mendimit

Korrektura:

Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Kjo trajtesë përmban dy tema:

Tema e parë: Kundërshtimi i argumenteve.

Tema e dytë: Favorizimi i mendimeve.

Hyrje

Disa dijetarë të usulit, si shumica absolute e dijetarëve Hanefijë, Hudariju, El-Bejdaviju dijetar Shafijë, e kanë përmendur këtë temë para temës së ixhtihadit dhe pasimit dhe pas temës së argumenteve sepse ka lidhje të fortë me argumentet sepse nuk mund të konkludohet dispozita me argumentime jo të sigurt pa e favorizuar njërin prej tyre.

Të tjerët si, shumica e Shafijëve, Malikijëve dhe Hanbelijve, e kanë renditur pas ixhtihadit sepse ai i cili i percepton kundërshtimet e argumenteve dhe favorizon në mes tyre është muxhtehidi.

Unë e përkrah rrugën e dytë sepse kundërshtimet paraqiten nga këndvështrimi i muxhtehidit dhe jo në ndodhinë apo në vetë çështjen, dhe siç do të shihet, nuk ka kundërthënie në shariatë dhe nga shkakut i argumenteve të ndryshme të shariatit në renditje të rangut të tyre në bazë të fuqisë, dhe muxhtehidi ka nevojë të dijë se cilit argument duhet t'i jepet përparësi dhe cilit jo, që të mos e merr argumentin e dobët duke e pasur argumentin e fortë se pastaj i bie sikurse me marrë tejemum kur veçse ka ujë, përpos kësaj, mund të paraqiten argumente të kundërta të barabarta përballë njëra-tjetrës, dhe në këtë rast çështja kthehet në pikën zero, e muxhtehidi ka nevojë t'i paraqes disa prej tyre për të favorizuar njërin mendim se përndryshe paralizohen argumentet dhe ligjet. Kjo është tema prej së cilës varet ixhtihadi, ku një çështje varet prej një pjese të saj apo të një kushti të saj, siç e thotë Ibni Bedrani.⁹⁶

Parimi i favorizimeve është formuluar me një formulim tjetër e ajo është të veshurit me fanatizmin medhhebor, e kjo çështje e ixhtihadit ka filluar nga fukahatë që nga gjysma e shekullit të pestë të hixhretit, pasi ata e kanë pëlqyer pasimin dhe polemikat dhe janë orientuar në favorizimin e medhhebit jashtë e brenda dhe në arsyetimin e ligjeve.

Me fjalën favorizim të brendshëm kemi për qëllim çka ndodhë me studentët dhe përkrahësit gjatë polemikave për të favorizuar një mendim ndaj tjetrit.

Sa i përket favorizimit të jashtëm, është ajo çka ndodhë në mes të dy medhhebeve.⁹⁷

Unë sot dëshiroj që dijetarët t'i shikojnë argumentet pa shikuar nga cili medhheb burojnë, për të arritur te mendimi përfundimtar duke u mbështetur në ato baza të cilat i kanë vendosur muxhtehidët si baza të favorizimit të mendimeve, siç paraqitet këtu me shembuj ilustrues të atyre bazave, duke vërejtur se unë kam lënë anash librat e njohura të usulit.

Tema e parë: Kundërshtimi në mes argumenteve

Këtu do të sqaroj:

- **esencën e kundërshtimeve,**
- **sferën e kundërshtimeve,**
- **dispozitën e kundërshtimeve të Hanefijetë dhe të shumica absolute e dijetarëve.**

Esenca dhe sfera e kundërshtimeve

Kundërshtim, gjuhësisht do të thotë, **kur secili e kundërshton mendimin e tjetrit**. Kjo ndodh kur secila çështje bëhet e kundërt me çështjen tjetër dhe e zëvendëson tjetrën duke u ndalur në atë pikë.

Në terminologjinë e usulit është atëherë kur **njëri prej argumenteve rezulton një dispozitë për një çështje në kundërshtim me rezultimin e argumentit tjetër me atë dispozitë.**⁹⁸

Kudamiju, kundërshtimin e definon kështu: **“Është shprehja e mohimit të dy e më shumë argumenteve varësisht se a sillen ato argumente përballë njëri-tjetrit, dhe është i pamundur unifikimi i tyre”**,⁹⁹ si f.v., njëri prej argumenteve rezulton obligimin, ndërsa tjetri ndalimin, e të ngjashme.¹⁰⁰

Shembull, kemi dy ajete në Kur'an:

- Njëri ajet idetin e gruas së cilës i ka vdekur burri e cakton në katër muaj e dhjetë ditë, pa marrë parasysh se a është shtatzënë apo nuk është shtatzënë.

- Ajeti tjetër përcakton që ideti i shtatzënë duhet të jetë deri sa të lind fëmija, pa marrë parasysh se a i vdes burri apo e shkurorëzon.

Kështu, në këndvështrimin e muxhtehidëve këto dy tekste shihen se janë të kundërta me njëra tjetrën.

Kemi edhe dy hadithe sa i përket kamatës:

- Hadithi i parë është thënia e pejgamberit s.a.v.s.: **“Kamata është dyfishimi.”**¹⁰¹

- Hadithi i dytë: **“Mos shitbleni grurë me grurë, përpos në masë të barabartë.”**¹⁰²

- Hadithi i parë, ndalimin e kamatës e përkufizon në kamatën dyfishuese dhe në bazë të saj lejohet kamata shtesë.

- Hadithi i dytë tregon se ndalohet kamata shtesë.

Kështu që, dy hadithet do të ishin në kundërshtim sa i përket kamatës shtesë, i pari tregon për lejim, ndërsa i dyti për ndalim.

Vërehet se kundërshtimi ndodh nga këndvështrimi apo si e parasheh muxhtehidi në bazë të perceptimit dhe aftësisë së kuptimit të tij dhe jo në ngjarjen dhe në vet çështjen, siç sqarova më herët, sepse kundërshtimi ka kuptimin e kontrastit, dhe është e pamundur që Ligjvënësi të sjell dy argumente të kundërta në të njëjtën kohë për të njëjtën çështje sepse kjo është tregues i paafësisë dhe ky mendim për Zotin e Lartmadhëruar është absurditet.¹⁰³

Shatibiju ka sqaruar se i tërë sheriatu islam përfundon në një mendim të vetëm në çështjet dytësore edhe pse mendimet janë të ndryshme dhe të shumta, ashtu siç është edhe me bazat e saj dhe nuk bën të jetë ndryshe dhe ai i ka paraqitur argumentet e qarta në lidhje me këtë çka e ka thënë.¹⁰⁴

Sfera e kundërshtimeve

Ndoshta çështja e kundërshtimeve është vetëm formalitet dhe nuk është substancial siç e përmendëm, dhe lejohet të ndodhë edhe në argumente të prera edhe jo të prera por të së njëjtës kategori dhe atëherë njëra prej tyre bartet te tjetra ose e shfuqizon njëra-tjetrën, nëse mësohet kronologjia e tyre dhe cila është e mëvonshme, siç do ta sqaroj.¹⁰⁵

Nuk lejohet kundërshtimi në mes të argumentit të prerë dhe jo të prerë dhe as në mes të tekstit dhe ixhmait dhe kijasit dhe as në mes të ixhmait dhe kijasit sepse e dobëta mohohet nga e forta dhe jo e prera mohohet nga e prera sepse kusht është që kundërshtimi të ndodhë kur të kundërshtohen dy argumente të shëriatit të së njëjtës forcë (kategori).¹⁰⁶

Një pjesë e dijetarëve të usulit e parashohin që kundërshtimi i argumenteve nuk ndodhë në mes të dy argumenteve të prera sepse kjo do të nënkuptonte bashkimin e dy të kundërtave dhe fuqizimin e tyre ndërkohë që janë të kundërta për të njëjtin person sepse argumentet e prera janë të sigurta dhe bindëse. Logjika nuk e pranon të favorizohet shkenca prej shkencës (argumentit shkencor me argumentin shkencor).¹⁰⁷

Sipas mendimit tim, përkufizimi i kundërshtimeve vetëm në argumente të pasigurta është vetëm presupozim, sepse kundërshtimi ndodh vetëm në aspekt të jashtëm, dhe ashtu siç mund të ndodhë kundërshtimi në mes të argumenteve të sigurta, mund të ndodhë edhe në argumente të prera.

Ajo çka vërehet është se, kundërshtimi nuk mund të paramendohet në mes të dy veprimeve nëse tek ne nuk vjen argument për përsëritjen e saj, si f.v., ligjësimi për agjërime të ditës së shtunë, e pastaj ligjësimi për kundërshtim në mes të këtyre dy veprimeve sepse nuk ka përgjithësim në vepra, siç do ta sqaroj më vonë.

Dispozita e kundërshtimeve apo mënyra e tejkalimit të kundërshtimeve

Nëse në shikim të muxhtehidit paraqitet kundërshtim në mes të argumenteve, ai duhet të hulumtoj për tejkalimin e kundërshtimeve. Për të realizuar këtë pikësynim janë dy rrugë:

- rruga e Hanefijëve dhe
- rruga e Shafijëve.

E para: Rruga e Hanefijëve

Hanefijtë deklarojnë: Kundërshtimi mund të jetë:

- ose në mes të teksteve të shariatit,
- ose në argumente tjera.

Nëse kundërshtimi është në mes të dy teksteve, muxhtehidi i kalon argumentet nëpër katër faza në bazë të kësaj renditjeje:¹⁰⁸

1. Shfuqizimi.

Është rruga kur muxhtehidi e hulumton kronologjinë e dy teksteve, kur ta mësoj, i jep përparësi të dytit ndaj të parit. Gjykon në atë mënyrë që i mëvonshmi e shfuqizon të mëhershmin, nëse janë të barabartë në fuqinë e tyre, ashtu që vjen në pyetje që njëra ta shfuqizoj tjetrën, si p.sh., me rastin e dy ajeteve apo ajetit me sunetin mutevatir apo meshhurë ose dy haditheve të vetmuara, si f.v., rasti i dy ajeteve, njëri i cili tregon idetin e gruas së cilës i vdes burri dhe tjetri kur gruaja e shkurorëzuar është shtatzënë. Ajeti i parë:

وَالَّذِينَ يُتَوَفَّوْنَ مِنْكُمْ وَيَذَرُونَ أَزْوَاجًا يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ
وَعَشْرًا

“E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë...” (El-Bekare : 234)

Ajeti në mënyrë të përgjithshme tregon se gruas së cilës i vdes burri duhet të pres afatin prej katër muaj e dhjetë ditëve, pa marrë parasysh se a është apo nuk është shtatzënë.

Ndërsa ajeti i dytë është:

وَأُولَاتُ الْأَحْمَالِ أَجَلُهُنَّ أَنْ يَضَعْنَ حَمْلَهُنَّ ۚ

“...për shtatzënat afati i pritjes së tyre është derisa të lindin..” (Et-Talakë : 4)

Ky ajet tregon se gruas shtatzënë i përfundon ideti pasi të lindë, pa marrë parasysh a i vdes burri i saj apo shkurorezohet.

Nga aspekti i jashtëm këto dy ajete kundërshtohen në mes vete. Transmeton Ibni Mes’udi se ajeti i dytë është më i mëvonshëm nga ajeti i parë në zbritje,¹⁰⁹ dhe e shfuqizon pjesën që duhet shfuqizuar, e ajo pjesë është shfuqizimi për gruan shtatzënë të cilës i vdes burri dhe ideti i saj përfundon pasi të lind, këtë mendim e kanë edhe shumica absolute e dijetarëve.

2. Përparësia.

Nëse muxhtehidi nuk e di kronologjinë e dy teksteve kundërshtuese, nëse ka mundësi, i jep përparësi njërit ndaj tjetrit në mënyrën të cilën do ta shpjegojmë se si duhet dhënë përparësi, si f.v.:

- përparësia e tekstit absolut ndaj tekstit interpretues,
- përparësia e tekstit ndalues ndaj atij lejues.
- përparësia e dy haditheve, ku secili është i vetëm, mirëpo transmetuesi i njërit është më i drejtë dhe më dijetar në fikh, e të ngjashme.

Hanefijtë i japin më shumë përparësi njërit prej dy argumenteve se sa bashkimit të tyre, sepse favorizimi i favorizuesit është çështje logjike. Shembull i kësaj është se Ebu Hanife i ka dhënë përparësi hadithit: **“Largohuni nga urina”¹¹⁰ dhe ajo çka është transmetuar për pirjen e**

irnijnëve (urinën e devesë).”¹¹¹ duke i dhënë përparësi ndalesës edhe pse ekziston mundësi që të përgjithshmen ta bartim në të interpretuarën ose vetëm në rast përdorimi si shërim¹¹² sepse largimi i dëmit ka përparësi ndaj sjelljes së dobisë.

3. Bashkimi dhe harmonizimi.

Kur është i pamundur favorizimi i ndonjërit prej argumenteve, muxhtehidi orientohet në bashkimin dhe harmonizimin në mes të dy teksteve sepse të vepruarit me njërin prej dy argumenteve ka përparësi ndaj lënies së argumenteve anash. Siç tregohet në librin “Muslimu Thubut” dhe në librat tjerë,¹¹³ mënyra e bashkimit dhe harmonizimit varet prej natyrshmërisë së teksteve:

- Muxhtehidi i bashkon dy tekste të përgjithshme duke shikuar llojin e njërit prej tyre.
- Muxhtehidi bashkon dy tekste të papërcaktuara duke shikuar se cili prej tyre është përcaktues.
- Në rastin e dy teksteve të posaçme, e bën pjesëzimin e specifikimit.
- Në rastin kur janë dy tekste, njëri i përgjithshëm, atëherë i jep përparësi tekstit specifikues ndaj atij të përgjithshëm.

Shembull i rastit të parë: Kur një person thotë “**jepi të varfërve**”. Ndërsa herën tjetër, i njëjti person thotë “**mos i jepni të varfërve**”, dhe nuk dihet se cila thënie ka qenë para tjetrës dhe secilës thënie ia jep kuptimin ashtu që:

- urdhri ka të bëjë për të varfrit jo lypës dhe të urtë e të moralshëm. ndërsa

- ndalesës ia jep kuptimin¹¹⁴ për ata të cilët zgjatin dorën duke kërkuar prej tjerëve.

Shembull nga suneti:

Thënia e Muhamedit a.s.: **“A dëshironi të ju tregoj për dëshmitarët më të mirë? Është ai i cili bëhet dëshmitarë para se të kërkohet dëshmia prej tij.”**¹¹⁵

Dhe thënia e Muhamedit a.s.: **“Më të mirët prej jush janë ata të cilët janë të gjeneratës sime, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj do të ketë popull të cilët bien dëshmorë dhe të cilët nuk dëshmojnë dhe nuk kërkojnë të dëshmojnë, mashtrojnë dhe atyre nuk u besohet.”** (Hadithë)¹¹⁶

Hadithi i parë lejon pranimin e dëshmisë para se të kërkojë pronari i së drejtës, pa marrë parasysh në të drejtat ndaj Allahut apo në të drejtat ndaj robërve.

Hadithi i dytë në esencë nuk e lejon. Kështu që hadithit të parë i jepet kuptimi i llojit të të drejtave e ai lloj është, të drejtat ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe dëshmia ka të bëjë me dëshminë e Hisbes (kontrollimit dhe inspektimit), ndërsa hadithit të dytë i jepet kuptimi i llojit të dytë, e ajo është dëshmia për të drejtat e robërve.

Shembull i së dytës – kur një person thotë: ***“jepi të varfrit”***,

ndërsa herën tjetër thotë ***“mos i jep të vafrit”***,

urdhri është për të varfërin jolypës, ndërsa

ndalesa për lypësin.

Shembull i së tretës: Kur një person thotë: ***“jepi Halidit”***

dhe herën tjetër thotë ***“mos i jep Halidit”***,

- urdhri i jepet rastit kur ai është i qëndrueshëm dhe i devotshëm, ndërsa

- ndalesa është kur ai devijon.

Shembull i së katërtës – thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَالْمُطَلَّاتُ يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ ثَلَاثَةَ قُرُوءٍ

“E ato gra që janë shkurorëzuar janë të obliguara të presin tri menstruacione..” (El-Bekare : 228)

Ky tekst është i përgjithshëm dhe tregon për obligueshmërinë e idetit për çdo grua, pa marrë parasysh kontaktimin apo moskontaktimin me të, mirëpo me ajet tjetër është specifikuar pas kontaktimit. Ky specifikim ka ndodhur me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نَكَحْتُمُ الْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ طَلَقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَمْسُوهُنَّ فَمَا لَكُمْ عَلَيْهِنَّ مِنْ عِدَّةٍ تَعْتَدُونَهَا

“O ju që besuat, kur të keni lidhur kurorë me besimtares e pastaj i lëshoni ato para se të keni kontaktuar me to, ju nuk keni të drejtë të kërkonit që ato të presin afatin e caktuar (iddetin).” (El-Ahzab : 49)

Ajeti i përgjithshëm vazhdon të veprohet edhe pas specifikimit.

Nëse njëri prej teksteve është i papërcaktuar, ndërsa tjetri i përcaktuar, atëherë i papërcaktuari bartet te i përcaktuari, siç dihet në këtë tematikë, thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

حُرِّمَتْ عَلَيْكُمُ الْمَيْتَةُ وَالْدَّمُ وَلَحْمُ الْخَنِزِيرِ

“Juve u janë ndaluar (t’i hani): ngordhësira, gjaku, mishi i derrit...” (El-Maide : 3)

dhe ajeti tjetër:

إِلَّا أَنْ يَكُونَ مِيتَةً أَوْ دَمًا مَسْفُوحًا

“...përveç në qoftë se është: cofëtinë ose gjak rrjedhës...” (El-En’am : 145)

Ajeti i parë është i papërcaktuar (gjaku) i cili përcaktohet me ajetin e dytë, ashtu që gjaku i cili ndalohet është ai rrjedhës.

4. I le anash të dy argumentet dhe argumentohet me argument të kategorisë më të ulët.

Nëse dy argumente kundërshtohen dhe rrugët e mëparshme nuk mund ta favorizojnë njërin prej tjetrit, atëherë i lëmë anash ato dy argumente duke pasur parasysh kundërshtimin mes vete dhe atëherë muxhtehidi i drejtohet argumenteve të cilat janë në kategorinë më të ulët.

Nëse dy ajete kundërshtohen mes vete, atëherë merret në konsideratë se si i parasheh suneti ato argumente.

Nëse dy hadithe kundërshtohen mes vete, atëherë ato dy hadithe lihen anash, duke shikuar në argumentimin e sehabiut, tek ata të cilët e marrin medhhebin e sehabiut si argument, ose duke shikuar në argumentimin e kijasit tek ata të cilët argumentohen me kijasë.

Arsyeja se muxhtehidi orientohet në argumentin e kategorisë më të ulët, për shkak të kundërshtimit mes vete dhe se të argumentuarit me njërin prej dy argumenteve kundërshtuese është favorizim me pa të drejtë favorizimi dhe ajo ndodhi mbetet pa dispozitë në rangun e kategorive më të larta.

Nëse nuk ka argument të kategorisë më të ulët të argumenteve kundërshtuese, atëherë veprohet me bazën e përgjithshme të asaj çështjeje, thuaja se në esencë nuk ka dispozitë në atë çështje.

Shembull të kategorisë më të ulët: Hadithet të cilat janë transmetuar me transmetime të kundërta me rastin e namazit të zënies së diellit me hënë.

Hadithi i parë është hadithi nga Nuëman bin Beshijr r.a. se pejgamberi s.a.v.s. ka falur namazin e zënies së diellit me hënën ashtu siç falemi me një rukuë dhe dy sexhde.¹¹⁷

Hadithi i dytë i transmetuar nga Aishja r.a. se pejgamberi s.a.v.s. i ka falur dy rekate me katër rukuë dhe katër sexhde.¹¹⁸

Hadithi i parë tregon për mënyrën e faljes së namazit të zënies së diellit me hënën është me një ruku, një qëndrim në këmbë siç është rasti me namazet.

Hadithi i dytë tregon se namazi falet me dy rukuë, dy në secilin qëndrim në këmbë të secilit rekat.

Nuk ka favorizues të njërit prej dy haditheve, atëherë nuk veprohet me asnjërin prej tyre, por veprohet me kijasin, e në bazë të kijasit namazi i zënies së diellit me hënën falet sikurse me rastin e namazeve tjera.¹¹⁹

Shembull i të vepruarit me bazën e përgjithshme: Ajo çka është gjurmuar rreth dispozitës së lëpirjes së gomarit në enë. Nga Ibn Umeri, është i papastër, nga Ibni Abasi, është i pastër. Hanefijtë nuk kanë vepruar me këto dy gjurmime duke vepruar me bazën e përgjithshme të ujit dhe se uji është i pastër në bazë të bazës së saj të përgjithshme.¹²⁰

Përderisa, sa i përket kundërshtimit të argumenteve përpos dy teksteve dhe dy analogjive, muxhtehidi duhet të favorizoj prej tyre në bazë të favorizimit të kijasit, si p.sh., favorizohet arsyeshmëria e tekstit ndaj arsyeshmërisë së përfutur i cili është prodhuar nga harmonizimi i arsyeshmërisë së tekstit.

Nëse ndonjëri prej analogjive nuk favorizohet ndaj analogjisë tjetër, muxhtehidi duhet vet të anoj se në cilin prej analogjive i pushon zemra dhe atëherë vepron me atë në të cilin i qetësohet zemra dhe nuk lejohet të

largohet nga ai derisa ta sheh tjetrin i cili është më i mirë dhe e ndryshon ixhtihadin e tij.

Shkaku se pse muxhtehidi duhet të kërkoj në veten e tij në cilin argument të anoj është se, të dy anët e këtyre analogjive kundërshtohen, andaj duhet të veproj me njërin prej dy analogjive e në të cilat nuk peshon asnjëra ndaj tjetrës, dhe i bie sikurse te e drejta e zgjedhjes së kompensimeve sepse Ligjvënësi e ka vendos si argument të sheriatit me të cilën muxhtehidi duhet të veproj me të dhe në anën tjetër duhet t'i anashkaloj për shkak të kundërshtimit në mes tyre, si te rasti i kundërshtimeve të dy teksteve dhe thonë, muxhtehidi gjykon dhe vepron në bazë të zemrës së tij.¹²¹

Shafiiju ka thënë: “Muxhtehidi zgjedh dhe jep fetva me cilindo prej dy mendimeve, nëse nuk mund të hasë në njërin prej dy analogjive sepse nuk do të kishte kuptim asgjësimi i tyre sepse do të rezultonte që çështja të mbetet pa dispozitë dhe nuk do të kishte kuptim të vepruarit me njërin prej tyre konkretisht sepse kjo është favorizimi me pa të drejtë favorizimi, andaj mbetet alternativa e zgjedhjes së njëres prej tyre.”¹²²

Hudariju ka thënë: “Tek ne nuk paraqet ndonjë domethënie ky anim të cilin e kanë paraparë Hanefijtë si zgjedhje të njëres prej tyre sepse animi në ixhtihadë është deri sa të arrihet te tjetra. Është obligative që kur të jenë dy analogji nuk ka përparësi njëra nga tjetra. Dhe nuk ka çka të thuhet tjetër përpos të thuhet: “Ai le të zgjedh njërin prej dy dispozitave.” Dallimi në mes të Hanefijve dhe Shafiijve është te rezultati:

Hanefijtë thonë: ***Nuk lejohet të ndryshoj mendimin nga ajo çka e ka zgjedhur, përpos nëse i paraqitet argument i cili është shkak i ndryshimit.***

Shafiijtë thonë: Ai ka të drejtë të zgjedhë atë që e ka zgjedhur më parë, përpos nëse është qëllim që muxhtehidi të pengohet që të pasoj epshin në ligjësimin e ligjeve. Kur njëra prej dy analogjive harmonizohet me dëshirën e tij veprohet me të dhe kur harmonizohet me tjetrën e ndryshon mendimin dhe nuk mendojmë se ndonjëri do ta lejonte këtë.¹²³

E dyta: Rruga e Shafiijeve në mënjanimin e kundërshtimeve

Medhhebi Shafiije ka sqaruar se kur dy analogji kundërshtohen në mes vete, muxhtehidi e favorizon njërin prej tyre siç do ta shpjegojmë, përderisa sa i përket asaj kur të kundërshtohen dy tekste, ashtu siç e parasheh muxhtehidi, sipas medhhebit Shafiije, Malikije, Hanbelije dhe dhahirije, muxhtehidi duhet të hulumtoj nëpërmjet këtij procesi dhe në këtë renditje.¹²⁴

1. Bashkimi dhe harmonizimi në mes të kundërshtimeve në aspektin të cilin e pranon arsyeja, sa të ketë mundësi, qoftë edhe në disa aspekte, atëherë veprohet me secilin prej tyre në raste konkrete dhe nuk lejohet favorizimi i tyre sepse të vepruarit me të dy argumentet ka përparësi ndaj asgjësimit të njërit prej tyre dhe në favorizimin e njërit prej tyre për shkak të faktit bazik se, të vepruarit me argument ka përparësi nga mosveprimi me të.

Mund të veprohet me të dy argumentet në tri raste:¹²⁵

a. Që dispozita nga të dy argumentet kundërthënëse mund të veprohet në disa pjesë si f.v.: Gjatë mosmarrëveshjes së dy personave ku, secili pretendon se shtëpia është e tij.

Është i pamundur të vepruarit me të dy pretendimet dhe me argumentet e secilit prej tyre. Gjykimi se shtëpia është pronë e njërit do të nënkuptonte se shtëpia nuk është e tjetrit

Ndodhemi në situatë ku nuk mund të bëhet bashkimi i dy argumenteve, mirëpo të vepruarit me ato dy argumente është i mundur në disa aspekte, bëhet përgjysmimi, sepse pronësia mund të pjesëzohet.

Shtëpia ndahet në mënyrë të përgjysmuar për secilin prej tyre, sepse e drejta në atë shtëpi në secilin prej tyre tregon argument se ka të drejtë pronësie, atëherë pronësia i nënshtrohet përgjysmimit dhe përgjysmohet, duke e bërë kështu bashkimin në mes të dy argumenteve në një aspekt prej aspekteve.

b. Që dispozita e secilit prej argumenteve është e shumënumërt, që do të thotë argumenti jep alternativa të dispozitave të shumta, atëherë është e mundur të veprohet me të dy argumentet dhe me secilin prej tyre vendoset nënligj sikurse thënia e pejgamberit s.a.v.s.: “Për fqinjin e xhamisë nuk ka namaz pos në xhami.”¹²⁶

Ky hadith është në kundërshtim me pranimin apo miratimin e pejgamberit s.a.v.s. për atë i cili nuk falet në xhami por falet jashtë xhamisë edhe pse është fqinj me xhaminë.¹²⁷

Këto dy argumente përmbajnë dispozita të ndryshme, varësisht prej situatës së secilit argument prej tyre

- Ka mundësi që hadithi i parë tregon për pranimin e namazit por tregon se nuk ka vlerë të madhe dhe nuk është namaz i përsosur ndërsa,

- Hadithi i miratimit ka kuptimin e pranimit të namazit.

c. Që dispozita e secilit prej dy argumenteve të jetë i përgjithshëm, që do të thotë për njësi të shumta, dhe atëherë është e mundur të veprohet me të dy argumentet ashtu që duke i shpërndarë nëpër njësi dhe argumentin e njërës dispozitë e ndërlidh te një pjesë, ndërsa argumentin e dispozitës tjetër e ndërlidh te një pjesë tjetër. Shembull: Dëshmitë më të mira të cilat i kemi përmendur më herët kur kishte kundërshtime.

Shembull tjetër, thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَالَّذِينَ يُتَوَفَّوْنَ مِنْكُمْ وَيَذَرُونَ أَزْوَاجًا يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ
وَعَشْرًا

“E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë.” (El-Bekare : 234)

dhe thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَأُولَاتُ الْأَحْمَالِ أَجَلُهُنَّ أَنْ يَضَعْنَ حَمْلَهُنَّ أ

“për shtatzënat afati i pritjes së tyre është derisa të lindin.” (Et-Talakë : 4)

Ajeti i parë në mënyrë të përgjithshme nënkupton se ideti i gruas së cilës i vdes burri përfundon pas katër muaj e dhjetë ditëve, pa marrë parasysh a është apo nuk është shtatzënë.

Ajeti i dytë në mënyrë të përgjithshme të saj nënkupton se gruas shtatzënë i përfundon ideti pasi që t'i lind fëmija, pa marrë parasysh a shkurorëzohet apo i vdes burri,

I bashkojmë dy ajetet dhe secilit prej ajeteve i japim kuptimin në njësinë e vet dhe jo në njësinë e tjetrit, kështu që veprohet me të argumentet në aspektet e tyre, siç kemi sqaruar edhe më parë.

2. **Favorizimi i argumenteve në mënyrën e favorizimit** të cilin do ta sqarojmë dhe do t'i sinjalizoj disa prej tyre në bazë të rrugës siç e kemi treguar më herët, ku muxhtehidi vepron tek pas hulumtimit dhe pas zbulimit të argumentit i cili favorizon dispozitën.

3. **Shfuqizimin e njëres prej dy argumenteve dhe të vepruarit me tjetrin**, nëse tregueshmëria e saj pranon shfuqizimin dhe dihet cili është i mëhershëm dhe cili është i mëvonshëm ashtu që i mëvonshmi e shfuqizon të mëhershmin.

4. **Anashkalimi i të dy argumenteve**. Nëse procedurat e mëhershme nuk janë të suksesshme atëherë nuk veprohet me asnjërin prej tyre dhe veprohet me argumente tjera dhe ngjarja mbetet e patekstualizuar. Kjo formë është vetëm presupozuese sepse nuk mund të ndodhin raste të tilla.¹²⁸

Tema e dytë: Favorizimi i argumenteve

Këtu do t'i sqaroj dy çështje të rëndësishme:

E para: Definicioni i favorizimit dhe sqarimin e argumenteve të cilat obligojnë veprimin për të favorizuar.

E dyta: Rruga e favorizimeve.

Definicioni i favorizimit dhe argumentet të cilat veprojnë për të favorizuar

Favorizim, gjuhësisht do të thotë *anim dhe dominim*. Si f.v., peshoj vaga, kur të anon, ndërsa në terminologjinë e dijetarëve të usulit kemi definicionet:

Ibni Haxhibi e definon: **Krahasimi i shenjave (që do të thotë argument jo i sigurt) që me to të fuqizohet kundër të kundërtës së saj.** Kështu ngjashëm e ka përmendur edhe el-Amediu.¹²⁹

Ky definicion është kritikuar sepse ka të bëjë në mes të dy favorizimeve sepse krahasimi bëhet në mes të dy favorizimeve në një ngjarje. Dhe kjo nuk ka të bëjë me favorizimin sepse favorizimi është në veprimet e një personi muxhtehidë, e cila është e kundërt në krahasime.

Shumica e Hanefijëve e definojnë kështu: **Një paraqitje shtesë e njëres nga të njëjtat me diçka çka nuk ndahet prej tyre.**¹³⁰ Nga kjo kuptohet se kundërshtimi nuk mund të jetë pos në mes të të njëjtave në forcë. Nuk thuhet: Kur'ani ka përparësi ndaj lajmit (hadithit) të vetmuar dhe as lajmi i vetmuar ndaj kijasit, edhe pse është thënë. Kijasi e ka kundërshtuar lajmin e vetëm dhe i është dhënë përparësi lajmit të vetëm ndaj kijasit.

Pjesa e definicionit nënkupton moslejimin e favorizimit me diçka çka nuk lejohet prej argumentit të pavarur.

Hanefijtë thonë se nuk lejohet favorizimi me argumentimet e shumta, si f.v., në njërën anë të jetë një hadithë, apo një analogji, ndërsa në anën tjetër dy hadithe apo dy analogji, sepse secili argument është i pavarur për të fuqizuar të kërkuarën dhe njëra nuk i bashkëngjitet tjetres sepse çështja forcohet nëpërmjet vet atributit të saj dhe jo duke ju bashkëngjitur diçka e ngjashme me të, që do të thotë se, çështja është se merret parasysh forca e vet argumentit dhe nuk lejohet favorizimi me argumente të shumta duke i dhënë përparësi kijasit ndaj lajmit të vetmuar i cili është kundërthënës me të dhe te kijasi tjetër harmonizohet me të, mirëpo të gjithë janë të pajtimit se lajmi i vetmuar ka përparësi ndaj kijasit edhe nëse forcohet me kijasë të ngjashëm.

Mendimin e tyre e kanë kundërshtuar shumica absolute e dijetarëve, ku sipas tyre i jepet përparësi kur të ketë argumente të shumta sepse qëllimi i favorizimit është forcimi i bindjes (mendimit) e cila buron nga shenjat kundërshtuese dhe forcimi i bindjes (mendimit) është arritur me argumentin i cili e forcon argumentin tjetër të ngjashëm në fuqizimin e dispozitës dhe kështu favorizohet ndaj të parës.

Analistët Shafijë e definojnë kështu, forcimi i njërës prej shenjave (argumenteve jo të sigurta) prej tjetrës për të vepruar me të¹³¹ është specifikuar në mes të dy argumenteve jo të sigurta sepse te ata favorizimi nuk bëhet në argumente për çështje të sigurta dhe as në mes të argumentit të sigurt me atë të pasigurt.

Në temën sfera e kundërshtimeve veç kam sqaruar debatin dhe kundërshtimet rreth kësaj çështjeje dhe i kam dhënë përparësi mendimit se kundërshtimet ndodhin njësoj si në argumente të sigurta ashtu edhe në të pasigurta, përderisa kundërshtimi ka të bëjë në vet muxhtehidin.

Shumica absolute e dijetarëve janë argumentuar se duhet të veprohet me argumentin favorizues si në vijim:

E para: Me ixhmain e sehaveve dhe të atyre që vijnë pas tyre në dhënien e prioritetit të disa argumenteve të sigurta në disa raste të ndryshme nëse i bashkëngjitet diçka çka e forcon një argument i cili është përballë argumentit tjetër si p.sh., përparësia e transmetimit të Aishes r.a. në lidhje **me prekjen e organeve intime të cilat e obligojnë gusulin,**¹³² me lajmin e Ebi Hurejres r.a. se **“Gusuli merret për lëndën ujore (kontaktimin intim).”**¹³³

Dhënia përparësi hadithit të pejgamberit s.a.v.s. se **është zgjuar xhunub (i papastër) përderisa ka qenë agjërueshëm,**¹³⁴ me transmetimin e Ebu Hurejres r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kush zgjohet xhunub (i papastër) nuk ka agjërim.”**¹³⁵ sepse ajo ka qenë më e ditur për gjendjen e pejgamberit s.a.v.s.

Aliu r.a. e ka fuqizuar (forcuar) lajmin e Ebu Bekrit r.a. dhe nuk e ka zëvendësuar atë, por ka zëvendësuar tjetrin pas tij.

Ebu Bekri Siddiki e ka fuqizuar lajmin (hadithin) e Mugires në trashëgiminë e gjyshes, kur së bashku me të ka transmetuar Muhamed bin Meslemete el-Ensariju.¹³⁶

Umeri r.a. e ka fuqizuar lajmin e Ebi el-Musa el-Eshariut në kërkimin e lejes, kur e vërtetoi Ebi Sead el-Hudriju transmetimin e tij.¹³⁷ E raste tjera me radhë.

Kështu, sehabet në bazë të ixhtihadit të tyre kanë obliguar të veprohet me mendimin favorizues të dy mendimeve të pasigurta dhe jo me mendimin më të dobët.

E dyta: Argumenti logjik – Të logjikshmit, me logjikën e tyre e bëjnë obligim që të veprohet me mendimin favorizues të ngjarjeve. Esenciale është që veprimet ligjore të zbresin në veprimet tradicionale.¹³⁸ Është gjurmuar nga Ibni Mes’udi se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: **“Atë që e shohin muslimanët të mirë edhe tek Allahu është e mirë.”**

Rrugët e favorizimit

Nuk mund të përkufizohen të gjitha rastet e kundërshtimeve sepse ato janë çështje të muxhtehidit, mirëpo unë do t'i sqaroj rastet më të rëndësishme. Ato ose mund të jenë në mes teksteve, ose analogjive.

Në rend të parë do të tregoj për rrugët e favorizimit në mes teksteve, e pastaj do të vazhdoj në favorizimin në mes analogjive. Do të flas shkurt për këtë temë, duke lënë hapësirë që kush të dëshiron të zgjerohet të shfletoj librat e usulit dhe posaçërisht librin “El-Ihkam” të Amediut,¹³⁹ i cili në mënyrë të shkëlqyer i ka paraqitur rastet e favorizimeve dhe i ka sistematizuar si është më së miri.

Favorizimi në mes teksteve

Favorizuesi, në mes teksteve i ka para vetes katër raste:

- 1. Nga aspekti zinxhiror,**
- 2. Nga aspekti i tekstit,**
- 3. Nga aspekti i ligjit apo tregueshmërisë,**
- 4. Nga aspekt i faktorëve të jashtëm.**

E para: Favorizimi në bazë të zinxhirit

Që është rruga e lajmit të tekstit. Shevkaniu thotë:¹⁴⁰ “Ekzistojnë dyzetë e dy lloje të favorizimit në mes teksteve nga ana e zinxhirit të tyre.” Pasi që i ka përmendur ka thënë: “Ta dish se. format e favorizimit janë të shumta, por përfundimi i tyre është se shumica e tyre janë se çka tregon për mendim dominues ai mendim është favorizues.”

Këto forma mund t’i përkufizojmë përafërsisht në katër lloje, e ato janë:

1. Favorizimi në bazë të transmetuesit.

Zinxhiri favorizohet në bazë të transmetuesve të shumtë ku transmetuesit e njërit raportim janë më të shumtë se transmetuesit e raportit tjetër, atëherë i jepet përparësi raportimit me më pak transmetues, pasi që mendimi më i fuqishëm është në të, sepse mundësia e gabimit apo e gënjeshtërs të shumica është më e largët se sa mundësia të e numrit më të vogël, kështu që vepohet me lajmin të cilin e kanë transmetuar shumica, e jo me lajmin të cilin e kanë transmetuar pakica. Është obligim të vepohet me më të fuqishmen, ky është mendimi i shumicës absolute.¹⁴¹

Ebu Hanife, Ebu Jusufi dhe el-Kerbiju thonë: Nuk favorizohet me transmetimet e shumta apo argumentet e shumta deri sa të mos arrihet deri te niveli i njohur¹⁴² analog me dëshminë sepse kur kundërshtohen dy dëshmi nuk favorizohet njëra dëshmi nga dëshmia tjetër për shkak të dëshmitarëve të shumtë nëse dëshmia tjetër e ka plotësuar pjesën e saj.

Replikë: Shumica e përforcon mendimin dhe dispozita favorizohet. Asnjëri nuk dyshon se shumica rezulton në forcën e vërtetimit. Dhe favorizimi e ka vetëm këtë kuptim. Për këtë arsye Kemal bin Hemami e ka zgjedhur favorizimin në bazë të numrit të shumtë të transmetuesve.

Hanefijtë janë argumentuar me argumente tjera, mirëpo të gjitha ato argumentime janë replikuar, saqë autori i librit “Muslimu Thubut” ka thënë:

“Nuk ka dyshim se ato forma janë të dobëta.” kjo aludon në ato në të cilat mbështeten Hanefijtë.”

Po ashtu *zinxhiri* favorizohet kur njëri prej raportuesve është më i ditur dhe më i përpiktë se sa tjetri ose më i mirë dhe më i devotshëm ose më i drejtë dhe më i besueshëm ose më dijetar i gjuhës arabe dhe i fikhut, atëherë raportimi i tij favorizohet sepse peshon mendimi ashtu siç favorizohet zinxhiri në të cilin transmetuesi mbështetet në ruajtje përmendësh ndaj zinxhirit i cili transmetues mbështetet në të shkruar sepse i pari është më i përpiktë.

Po ashtu, i jepet përparësi transmetimit të hadithit meshhurë (hadithë i përhapur në masë) ndaj hadithit i cili nuk është meshurë (hadithë i cili nuk është i përhapur në masë).

Ekzistojnë edhe mënyra tjera të favorizimeve, si veprimi me disa prej transmetuesve ose pse janë të njohur për kah prejardhja, ose që janë meshkuj, ose që janë të lirë, ose të dëgjuar, të drejtpërdrejtë, ose me dëgjim sa më të afërt, këto mënyra e ngritin vlerën e zinxhirit, ose bindjes së sigurtë, ose që e njeh çështjen, ose që ka qëndruar me muhadithë, ose me njerëz të mençur, e të ngjashme, në të cilët peshon mendja në transmetimin e vlefshëm.¹⁴³

2. Favorizimi në vet raportin (Hadithin), që do të thotë, në natyrshmërinë e raportit:

- i jepet përparësi hadithit mutevatir ndaj hadithit meshhurë,
- i jepet përparësi hadithit meshhurë ndaj lajmit të vetmuar,

kjo nga shkaku se hadithi mutevatir është më bindës, hadithi meshhurë është më afër bindjes, përderisa lajmi i vetmuar është më pak i sigurt.

Hadithit të ngjitur i jepet përparësi ndaj hadithit të shkëputur, për shkak të njohjes së transmetuesit të parë dhe mosnjohjes së transmetuesit tjetër.

I jepet përparësi hadithit i cili përfundon te tabiiju (gjenerata e dytë), para hadithit i cili përfundon te tebei tabiiju (gjenerata e tretë), sepse dihet se tabiiju (gjenerata e dytë) transmeton prej sehabiut, ndërsa sehabet janë të drejtë sepse i ka lavdëruar pejgamberi s.a.v.s. dhe pastërtinë e kanë të dëshmuar nga Kur’ani dhe suneti. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Më të mirët prej juve janë gjenerata në të cilën jam edhe unë.”**

Favorizohet hadithi zinxhiror në librat e muhadithëve, nga ajo e cila vërtetohet nga rrugët tjera të njohura dhe që nuk është përshkruar personalisht për ato transmetues sepse mundësia e vërtetësisë është më e madhe se sa e dyta, për shkak se muhadithinët janë më të përpiktë.

Favorizohen librat më të sakta, si të Buhariut dhe Muslimit, ndaj librave të njohur për sehabet siç janë musnedi i el-Ferdevisit dhe i Dejemijut e të tjerëve.

Ekzistojnë edhe dy favorizime tjera si f.v., favorizimi i transmetimit gojor ndaj transmetimit lejuar apo çka e ka arritur vet transmetimi.

Favorizohet transmetimi shprehimor ndaj transmetimit me kuptim.

Favorizohet transmetimi i dëgjuar brenda mureve ndaj transmetimit të dëgjuar prapa mureve.

Favorizohen transmetimet të cilat nuk kanë pasur mospajtime për shkak se më larg është ai transmetim nga ngatërrimi se sa transmetimi për të cilin ka pasur mospajtime.¹⁴⁴

3. Favorizimi në bazë të transmetuarës.

Favorizohet hadithi i dëgjuar nga pejgamberi s.a.v.s. ndaj të thënurit prej librit sepse transmetimi i dëgjimit është më larg gabimit se sa ai i cili e ka lexuar prej librit.

Favorizohet e dëgjua prej pejgamberit s.a.v.s. ndaj të transmetuarës se çka ka ndodhur në atë kuvend, ose që ka ndodhur në kohën e tij dhe ai ka heshtur sepse e transmetuara prej dëgjimit nga Muhamedi a.s. është më larg harresës se sa e transmetuara prej ndonjë kuvendi ku ai s.a.v.s. ka heshtur.

Favorizohet transmetimi i thënë (fjalor) nga transmetimi i të vepruarit sepse raportimi i fjalëve është më i fuqishëm se sa transmetimi se si ka vepruar, si p.sh., kur transmetuesi thotë, ka urdhëruar, ose ka ndaluar, ose ka lejuar. Këto kanë përparësi ndaj të treguarit të veprimit në kohën e pejgamberit s.a.v.s.

Po ashtu favorizohet lajmi i vetmuar veprimi i të cilit ka marrë përmasa shoqërore se sa lajmi i vetmuar i cili nuk ka marrë përmasa shoqërore sepse të veçuarit e njërit duke transmetuar diçka çka ka marrë përmasa shoqërore

dhe duke i plotësuar kushtet e atij transmetimi ka më pak mundësi që të jetë gënjeshtër. E kështu me radhë raste të ngjashme të cilat peshojnë anën më të fuqishme ndaj anës më të dobët.¹⁴⁵

4. Favorizimi për çka transmetohet. Favorizohet hadithi për të cilin janë ngritur dyshime për ta mohuar, ndaj hadithit për të cilin janë ngritur dyshime për ta mohuar atë transmetim, si f.v., hadithi i Zehras, sepse ka më pak dyshime.

Po ashtu, favorizohet hadithi i cili mohohet në bazë të saj, ndaj hadithit i cili mohohet në pjesën dytësore të saj.

Favorizohet transmetimi (e raportuara) e cila mohohet për shkak të hedhjes së dyshimit për harresë kundrejt transmetimit të cilit i hedhet dyshimi për gënjeshtër apo shtrembërim me qëllim sepse mendja anon në transmetimin e parë ndaj të dytit.¹⁴⁶

E dyta: Transmetimi nga aspekti i tekstit

Me tekst, kemi për qëllim çka përmban Kur'ani, suneti dhe ixhmai, prej urdhëresave, ndalesave, teksti i përgjithshëm, specifik, e të ngjashme.

Amediju i përmend pesëdhjetë e një mënyra të favorizimeve të cilat kanë të bëjnë me tekstin.¹⁴⁷ Prej tyre:

- Urdhëresa ka përparësi ndaj ndalesës sepse të vepruarit me të parën është veprimi mbi të dytën. Prej tyre:

- Fjala në kuptim të drejtë ka prioritet ndaj fjalës alegorike sepse fjala në kuptim të drejtë nuk ka nevojë për faktorë të jashtëm dhe mendja anon në atë drejtim. Prej tyre:

- Fjala specifike ka përparësi ndaj fjalës së përgjithshme, pra në atë masë në të cilën përputhen sepse fjala specifike është më e fuqishme në tregueshmëri dhe më specifike për të ardhur deri te e kërkuara.

Kjo dhe... nëse fjala specifike dhe fjala e përgjithshme janë të papërcaktuara, përderisa nëse fjala e përgjithshme dhe fjala specifike kanë edhe kuptim tjetër dhe nëse gjendet diçka çka e favorizon njërin ndaj tjetrës nga ndonjë faktor i jashtëm, veprohet në bazë të asaj çka është specifikuese, por nëse nuk ka ndonjë faktor i cili favorizon njërin ndaj tjetrës, atëherë muxhtehidi e zgjedh cilën dëshiron ai, sipas Shafiijeve, ose në atë të cilën i pushën zemra, te Hanefijtë, siç e kemi sqaruar më herët. Shkaku se nuk veprohet me fjalën specifike prej tyre sepse secila prej tyre është e përgjithshme në një aspekt dhe specifik nga aspekti tjetër dhe nuk veprohet konkretisht me njërin prej tyre pa fakt favorizimi sepse kjo do të ishte prejudikim.

Shembull: Thënia e Muhamedit a.s.: **“Kush flenë para namazit, ose e harron, le ta falë kur t’i kujtohet.”**,¹⁴⁸

kur edhe e ka ndaluar faljen e namazit në kohë të caktuara ndaluese.¹⁴⁹

Hadithi i parë është i përgjithshëm për namaze dhe specifik nga aspekti i kohëve, në kohët në të cilat është e urryer, siç dihet.

Ebu Hanife r.a. ka thënë: I jepet përparësi hadithit në të cilin përkufizohet koha, që do të thotë se nuk lejohet falja e namazeve kada në kohët kur është mekruh falja e namazit.

Shevkaniju thotë: “Nuk shikohet kështu.” Shafiiju r.a. thotë: “Pasi që ka ndodhë specifikimi në hadithet me të cilët është ndaluar namazi në kohët e caktuara me ixhmain për faljen e namazit të xhenazes dobësohet tregueshmëria, kështu që i jepet përparësi haditheve për faljen e namazeve kada, namazit të përshëndetjes së xhamive, e të ngjashmeve.”

Prej tyre: Fjala e përgjithshme e cila nuk është specifikuar ka përparësi ndaj fjalës së përgjithshme e cila është specifikuar, sepse ndërhyrja e specifikimit e ka dobësuar fuqinë e saj dhe bëhet fjalë alegorike, kështu që fjala e përgjithshme e cila nuk është specifikuar ka përparësi, për shkak se nuk ka ndërhyrë dobësues në të.

Prej tyre, te Hanefijtë:

- fjala eksplicite ka përparësi ndaj fjalës interpretuese,
- fjala interpretuese ka përparësi ndaj fjalës tekstuale,
- fjala tekstuale ka përparësi ndaj fjalës së qartë,
- fjala e qartë ka përparësi ndaj fjalës cilësuese (kenaje),
- fjala alegorike ka përparësi ndaj fjalës dykuptimëshe,
- fjala shprehimore ka përparësi ndaj fjalës sinjalizuese,
- fjala sinjalizuese ka përparësi ndaj fjalës treguese, dhe
- fjala treguese ka përparësi ndaj fjalës mbështetëse.

Prej tyre, shumësi i shquar ka përparësi ndaj shumësit të pashquar sepse në të parën nuk ka ndërhyrë ndonjë çështje dyshuese ndërsa në të dytën po.

Prej tyre: Fjala ka përparësi ndaj veprës sepse është më sqaruese se sa të vepruarit, e favorizimet tjera të ngjashme me radhë.¹⁵⁰

E treta: Favorizimi nga aspekti i gjykimit (dispozita) apo tregueshmërisë

Shevkaniju i ka përmendur¹⁵¹ gjashtë lloje të favorizimeve nga aspekti i tregueshmërisë.

Amediu i ka paraparë njëmbëdhjetë lloje.¹⁵²

Prej tyre: Që njëri prej teksteve të jetë për ndalim ndërsa tjetri për lejim. Për këtë kanë dhënë mendime të ndryshme.

Shumica absolute e dijetarëve thonë se i jepet përparësi ndalesës ndaj të lejuarës.

Ebu Hashimi, Isa bin Ebani dhe Gazaliu, kanë thënë se të dy argumentet janë të barabarta në forcën e tyre dhe bien poshtë dhe veprohet me të dyja. Në këtë rast, me fjalën lejim kemi për qëllim lejimin e veprimit dhe lejimin e mosveprimit ku bëjnë pjesë terminologjitë: mekruh, mendub dhe mubah dhe siç ka treguar Ibni Haxhibi, ndalimi është në të gjitha dhe favorizohet ndaj tyre.

Një pjesë e dijetarëve thonë se i jepet përparësi të lejuarës ndaj të ndaluarës.¹⁵³

Shumica absolute e dijetarëve argumentohen me dy çështje:

E para: Thënia e pejgamberit s.a.v.s.: “**Çdo herë kur të bashkohet hallalli dhe harami, harami e dominon hallallin.**”¹⁵⁴

Po ashtu thënia e pejgamberit s.a.v.s.: “**Lëre atë që dyshon, për atë që nuk dyshon.**”¹⁵⁵ Kjo tregon për favorizimin e haramit ndaj hallallit.

E dyta: Rezerva nënkupton të merret parasysh ndalimi sepse ndalesa nënkupton të larguarit nga veprimi. Në fakt, nëse veprimi është haram dhe në veprimin e saj është dëmi, edhe po të mos ishte në esencë haram, pra të ishte e lejuar, nuk do të kishte dëmtim në largimin prej atij veprimi sepse nuk ka dënim në largimin e të lejuarës.

Shembull: Nëse në një çështje konkrete bashkohet e ndaluara dhe e lejuara, si f.v., lindja e kafshës në mes të ngrënies së mishit dhe mosngrënies së mishit, i jepet përparësi ndalimit ndaj lejimit.

Gazaliu dhe të tjerët me të, argumentohen me atë se: Teksti lejues e forcon bazën e lejimit të çështjeve, e ajo bazë pra është lejimi, ndërsa teksti ndalues favorizohet si tekst rezervë. Në barazimin e tyre, bien prej përdorimit që të dy argumentet, se përndryshe do të prejudikohet në njërin pa të drejtë prejudikimi, ose në bashkimin e të dy argumenteve dhe të vepruarin me secilin prej tyre.

Replikë - Hadithin të cilin e kanë sjellë shumica absolute e dijetarëve është favorizimi i të ndaluarës ndaj të lejuarës. Nuk ka barazim në mes tyre, kështu që i jepet përparësi të ndaluarës.

Ata të cilët i japin përparësi të lejuarës ndaj të ndaluarës argumentohen me atë se teksti i së lejuarës e forcon bazën ligjore, e ajo bazë është lejimi, kështu që i jepet përparësi ndaj të ndaluarës.

Replikohet me atë se hadithi i mëparshëm është tekst i cili tregon të kërkuarën. Po ashtu edhe të vepruarit me të ndaluarën është më e preferuar. Kjo nga shkakut se është në kundërshtim me bazën, e ajo është lejimi.

Prej tyre: Kur njëri prej teksteve treguese tregon për ndalimin ndërsa tjetri për obligimin.

Raziu dhe pasuesit e tij thonë se, nuk veprohet me to, por anashkalohen nga shkakut se janë të barabartë mes vete sepse nëse i japim konkluzionin e të ndaluarës për të fitohet ndëshkimi, nëse veprohet me të. Ndërsa teksti obligativ, nëse nuk veprohet me të, fitohet ndëshkimi, dhe kjo nga shkakut se në secilën prej tyre rezulton mëkati.

Amediu dhe Ibni Haxhibi thonë se: I jepet përparësi ndalesës ndaj obligimit sepse ligji dhe të logjikshmit përkujdesen për largimin e dëmit të sigurt dhe përkujdesen për sjelljen e dobive.¹⁵⁶

Prej tyre: Kur njëri prej teksteve është fuqizues, ndërsa tjetri mohues, si f.v., lajmërimi i Bilallit r.a. se **pejgamberi s.a.v.s. ka hyrë brenda në Qabe dhe ka falur namaz.**¹⁵⁷ Ndërsa lajmi i Usames është se **pejgamberi s.a.v.s. ka hyrë në Qabe dhe nuk është falur.**¹⁵⁸ Po ashtu lajmi i Ibni Abasit se **Muhamedi a.s. është martuar me Mejmunen derisa ishte i veshur me ihram të haxhit.**¹⁵⁹ Ndërsa në një transmetim tjetër, **pejgamberi s.a.v.s. është martuar pasi që është liruar nga ihrami.**¹⁶⁰ Këto janë çështje debatuese.¹⁶¹ Shumica absolute e dijetarëve i japin përparësi tekstit fuqizues ndaj atij mohuese sepse fuqizimi përmban dituri shtesë sikurse me rastin kur kundërshtohet kritika negative me atë pozitive, ku i jepet përparësi kritikës negative.

Shafiiju thotë se i jepet përparësi mohimit ndaj fuqizimit sepse fuqizuesi ka përparësi ndaj mohuesit për shkak se përmban dituri shtesë, vetëm se po të kishim mundësi t'i japim përparësi mohimit ndaj fuqizimit (do të thotë të fuqizohet para saj) vlera e saj do të ishte vërtetimi, që do të thotë, vërtetimi i ligjit bazë, e ajo është se nuk ka ngjarë asgjë. Por, po ta përcaktonim më vonë (që do të thotë fuqizimi pas saj), vlera (domethënia) e saj do të ishte themelimi i ligjit të ri, kështu që vlera e themelimit të ri ka përparësi. Kështu që përcaktimi për vonimin e saj ka përparësi.

Isa ibn Ebani, Gazaliu dhe kadiu Abdul Xhebbbar, kanë thënë: Mohuesi është i njëjtë si fuqizuesi (deklaruesi, vërtetuesi) dhe nuk i jepet përparësi njëres ndaj tjetres, por duhet shikuar favorizimi me ndonjë faktorë të jashtëm sepse mund të ndodhin në të dy rastet dhe të mos ketë në mes tyre kundërshtues.

Hudariu i ka dhënë përparësi këtij drejtimi në rast se kundërshtimi ka të bëjë me lajmin e martesës së pejgamberit s.a.v.s. me Mejmunete bint el-Harithin el-Helalijën sepse nëse transmetuesit janë vet Mejmunete, e përcaktojnë se pejgamberi s.a.v.s. është martuar kur ka qenë i liruar nga ihrami i haxhit.

Ndërsa Ibni Abasi thotë se pejgamberi s.a.v.s. është martuar derisa ishte në ihram të haxhit. Logjikisht duhet të jetë që njëra prej dy transmetimeve veç ka gabuar sepse atë çka kanë transmetuar nuk është çështje prej ixhtihadit të tyre, por janë çështje të cilat ndërlidhen me shqisat e njeriut. Ihrami ka formë të posaçme e cila dallon nga forma e veshjes së rëndomtë

dhe kur ta kuptojmë gabimin e njërit prej transmetimeve, patjetër që duhet të hulumtojmë në to, por jo sipas mënyrës të cilën e kanë përmendur Hanefijtë (të cilët thonë: Kurorëzimi në kohën e haxhit me ihram lejohet) deri sa të na qetësohet zemra në njërën prej favorizimeve të dy transmetimeve.¹⁶²

Prej tyre: I jepet përparësi mënjanimi të dënimit nga përcaktimi i dënimit të tij sepse dënimi është dëmtim, ndërsa dëmtimi në islam mënjanohet (mohohet). Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Mos dëmtoni dhe mos u dëmtoni në islam.”**¹⁶³ dhe mënjanimi i dënimit për shkak të hamendjes sepse Muhamedi a.s. ka thënë: **“Mënjanhuni nga dënimet për shkak të dyshimeve.”**¹⁶⁴

Gazaliu thotë: “Ai i cili e mënjanon dënimin nuk i jepet përparësi ndaj ekzekutimit edhe pse dënimi nuk realizohet kur ekziston dyshimi.”¹⁶⁵

Prej tyre: Nëse ligji i tekstit është ligj vendosës i jepet përparësi ndaj tekstit të ligjit ngarkues sepse ligji vendosës nuk varet ashtu siç varet ligji ngarkues në imunitet obligativ.

Hanefijtë dhe shumica e Shafijëve i japin përparësi ligjit obligativ ndaj ligjit vendosës sepse ligji obligativ është më shpërblyes dhe në të pikësynohet ligji prej Ligjvënësit.

Prej tyre: Ligjit më të lehtë i jepet përparësi ndaj ligjit më të rëndë sepse sheriati është vendosur për lehtësim, siç thotë Zoti i Lartmadhëruar:

يُرِيدُ اللَّهُ بِكُمُ الْيُسْرَ وَلَا يُرِيدُ بِكُمُ الْعُسْرَ

“All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju.” (El-Bekare : 185)

dhe ajeti tjetër

وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُم فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ

“dhe nuk ju bëri vështirësi në fe.” (El-Haxh : 78)

Është thënë: I jepet përparësi ligjit më të rëndë sepse qëllimi i obligimeve është realizimi i dobive të të ngarkuarve dhe në veprën më të rëndë dobia është më e madhe se sa te vepra më e lehtë,¹⁶⁷ siç ka thënë pejgamberi s.a.v.s.: **“Shpërblimi yt në bazë të mundësisë tënde.”**¹⁶⁸

E katërta: Favorizimi nga çështjet rrethanore

Varësisht nga faktorët rrethanor, Shevkaniu i ka përmendur dhjetë lloje të favorizimeve.¹⁶⁹

Amediju i ka paraparë pesëmbëdhjetë lloje.¹⁷⁰

Disa prej tyre i kam zgjedhur për ilustrim:

1. Një argument favorizohet nga tjetri nëse atë e mbështet argumenti tjetër prej Kur'anit, ose prej sunetit, ose prej ixhmailit, ose prej kijasit, ose prej argumentit logjik ose shqisor, të cilat e forcojnë anën të cilën Ligjvënësi ka për qëllim ta tregoj.

2. Favorizohet argumenti me të cilin kanë vepruar banorët e Medines, ose halifet e drejtë, ose disa dijetarë të umetit. Kjo sepse banorët e Medines janë më të ditur për zbritjen e Kur'anit dhe më me përvojë për ndodhitë e shpalljes dhe të interpretimit dhe se pejgamberi s.a.v.s. ka nxitur që të pasohen halifet e drejtë dhe mbështetjen në to dhe se çka veprojnë një pjesë e dijetarëve të umetit, na e shton forcën që të mendojmë si ata dhe për këtë arsye ka përparësi.

3. Favorizohet teksti në të cilën përmendet ligji i sheriatit në arsyeshmëri se sa ligji i sheriatit pa urtësi (arsyeshmëri), për shkak se më lehtë perceptohet dhe pranohet me shpejtësi ashtu siç favorizohet ligji duke treguar shkakun para ligjit të cilit nuk i është treguar shkakun sepse kjo tregon përkushtim më të madh në transmetuesin i cili e transmeton.

4. Favorizohet njëri prej dy argumenteve i cili është më afër pafajësisë sepse kjo do të ishte më afër për të realizuar dobinë dhe për të larguar dëmin.

5. Favorizohet transmetimi të cilit i bashkëngjitet interpretimi sepse kështu tregohet se transmetuesi e di shumë mirë atë të cilën e transmeton.

6. Favorizohet ajo çka pikësynohet në sqarimin e ligjit për të cilin ka dallime ndaj tjetrit i cili ka dallime dhe nuk ka sqarime sepse ajo që pikësynon në sqarimin e ligjit është bazë e së dëshiruarës. Shembull: Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe që t’i bashkoni dy motra (në një martesë) pos asaj që ka qenë më parë.” (En-Nisa : 23).** Me këtë ka dashur të sqaroj ndalimin e bashkimit në mes të dy motrave në kontakt intim nëpërmjet aktit të kurorëzimit apo pronësimit të mëparshëm dhe i jepet përparësi ndaj ajetit tjetër **“ose çka keni në pronësi.” (En-Nisa : 43).** Ajo çka kuptohet është se është bërë përgjithësimi në dy motra dhe në të tjera sepse nuk ka qenë qëllimi me të në bashkimin në mes të dy motrave.

Favorizimi pas krahasimeve

Shevkaniu i ka përmendur shtatë lloje të favorizimeve pas krahasimeve, mirëpo mund t'i përmbledhim në katër prej tyre:

- Favorizimi nga aspekti i bazës,
- Favorizimi nga aspekti i degës,
- Favorizimi nga aspekti i arsyes,
- Favorizimi nga faktorët rrethanor.

E para: Favorizimi nga aspekti i bazës

Amediu i ka përmendur gjashtëmbëdhjetë lloje të favorizimeve të cilat kanë të bëjnë me ligjin bazë.¹⁷¹

Bejdaviju dhe Shevkaniu dhe të tjerët e kanë ndarë në dy pjesë:

- pjesa, varësisht prej argumentit ligjor,
- pjesa, varësisht prej mënyrës së ligjit.¹⁷²

Unë kam zgjedhur shembull i cili ndërlidhet me argumentin ligjor,¹⁷³ përderisa sa i përket çka ka të bëjë në vet ligjin është kuptuar në atë që kemi përmendur në temën “Favorizimet në mes të teksteve nga aspekti i ligjit.” ku përmendej se i jepet përparësi asaj çka rezulton ndalesën ndaj asaj që rezulton lejimin dhe i jepet përparësi asaj që arsyeshmëria e fuqizon atë ligj, para arsyeshmërisë e cila e mohon atë ligj.

E para: Favorizohet kijasi, ku ligji i së cilës është bazë e prerë, ndaj kijasit ku ligji i së cilës është jo i prerë sepse peshon në mendim sepse në esencë nuk mund të hidhet dyshimi.

E dyta: Favorizohet çështja, ligji i së cilës është ixhmai, nga çështja, ligji i së cilës është teksti sepse ka mundësi që teksti të specifikohet, të shfuqizohet ose të interpretohet, ndërsa ixhmai nuk i pranon këto. Imam Haremejni ka thënë: “I jepet përparësi asaj çka fuqizohet me tekst, pa marrë

parasysh prej Kur'anit apo sunetit ndaj ixhmait, sepse ixhmai është degë e tekstit sepse është i fuqizuar prej saj dhe nuk ka dyshim se baza ka përparësi ndaj degës. Kështu e ka thënë edhe Bejdaviju, autor i librit **“Ibhaxh”**.

E treta: I jepet përparësi asaj e cila shkon sipas rregullave të kijasit ndaj asaj e cila nuk shkon sipas rregullave të kijasit sepse është më larg nga zbatimi dhe më afër logjikës.

E katërta: I jepet përparësi asaj çka tregon argument specifik në arsyetimin e lejimit të kijasit me të, ndaj asaj çka nuk është kështu sepse është më larg në mundësinë e tij që të sillet diçka në kuptim zbatimi dhe përkufizimit të tij në bazën e cila është afuar.

E pesta: I jepet përparësi ajo për të cilën unanimisht janë pajtuar për mosshfuqizimin ndaj asaj për të cilën ka pasur dallime për shfuqizimin sepse esenciale është mosshfuqizimi, kështu që favorizohet mosshfuqizimi.

E gjashta: I jepet përparësi analogjisë së çështjeve specifike ndaj analogjisë së çështjes së përgjithshme të cilën e dëshmojnë rregullat.

Përfunim: I jepet përparësi asaj çka argumenti bazë është më i fuqishëm se sa argumentet tjera.

E dyta: Favorizimi nga aspekti i degës

Favorizohet njëra nga dy analogjitë, varësisht prej degës, në katër lloje:¹⁷⁴

1. Favorizohet analogjia në të cilën analogohet dega e bazës në ligjin konkret dhe të arsyeshmërisë konkrete ndaj analogjisë në të cilën është analoguar dega e bazës në llojin e ligjit dhe në llojin e arsyeshmërisë ose në llojin e ligjit dhe arsyeshmërinë konkrete ose në llojin e arsyeshmërisë dhe ligjin konkret sepse bartja e ligjit prej bazës te dega duke marrë parasysh se merr pjesë kuptimi më specifik dhe më i përgjithshëm, anon në mendim ndaj analogjisë në të cilën merr pjesë vetëm kuptimi i përgjithshëm.

Bazuar në këtë, i jepet përparësi kijasit i të cilit baza dhe dega kanë përbashkësi në arsyeshmërinë e njëjtë dhe në llojin e ligjit dhe anasjelltas ndaj përbashkësisë në llojin e ligjit dhe në llojin e arsyeshmërisë ashtu siç i jepet përparësi kijasit të të njëjtës arsyeshmëri dhe të llojit të ligjit ndaj përbashkësisë së të njëjtit ligj dhe të llojit të arsyeshmërisë sepse arsyeshmëria është boshti i zbatimit siç e kemi shpjeguar te tema e kijasit.

2. Favorizohet kijasi, dega e të cilit është më e vonshme se sa baza e saj ndaj kijasit të cilit dega e saj është më e hershme se sa baza, për shkak se e para është më e vështirë të shpartallohet se sa e dyta.

3. Favorizohet kijasi, arsyeshmëria e të cilit është e prerë në degën e saj, ndaj kijasit, arsyeshmëria e të cilit është jo e sigurt sepse është më afër mendjes dhe më larg nga mundësia e kritikës.

4. I jepet përparësi asaj në të cilën ligji i degës është marrë nga teksti në mënyrë globale të sqaruar ndaj asaj e cila nuk është kështu sepse kjo është më afër mendjes dhe më larg mospajtimeve.

E treta: Favorizimi në bazë të arsyeshmërisë

Favorizimet të cilat kanë të bëjnë me arsyeshmërinë e kjasit janë dy llojesh:

E para: Favorizimi në bazë të procesit nëpër të cilin është prodhuar arsyeshmëria, që do të thotë, rrugët e vërtetimit të arsyeshmërisë.

E dyta: Favorizimi në bazë të cilësisë së arsyetimit.

Sa i përket llojit të parë: Favorizimi në bazë të rrugës së prodhimit të arsyeshmërisë, ai është shumë llojesh dhe unë i kam zgjedhur si në vijim:¹⁷⁵

1. Favorizohet arsyeshmëria e prerë, si f.v. arsyeshmëritë prej teksteve dhe të ixhmailt, ndaj arsyeshmërive jo të sigurta sepse e para është më afër logjikës.

2. Favorizohet arsyeshmëria e prodhuar nëpërmjet detajimit dhe selektimit ndaj arsyeshmërisë së prodhuar nëpërmjet rrugës së harmonizimit dhe të rotacionit. Sepse ligji në degën ashtu siç varet në realizimin në atë çka është në bazën varet në mohimin e kundërshtuesit në bazë. Detajimi dhe selektimi bëhet për të sqaruar çka e shtyn për të mohuar elementin në bazë, e që e kundërta është me prodhimin e arsyeshmërisë me harmonizim sepse në esencë nuk paraqitet element në të e cila e mohon elementin në bazë dhe nuk ka dyshim se ajo çka tregon për harmonizimin e arsyeshmërisë ka përparësi ndaj asaj e cila e mohon arsyeshmërinë në një pjesë të bazës sepse e tregon arsyeshmërinë e plotë dhe jo arsyeshmërinë jo të plotë.

E kundërta është edhe me rregullin e rotacionit apo të kundërtën e saj sepse detajimi dhe selektimi është argument i qartë i cilësisë së arsyeshmërisë. Ajo çka sillet paralelisht me ligjin, pra në ekzistimin dhe në mosekzistimin e tij dhe se ligji sillet (rrotullohet) me atributet dëbuese të cilat nuk e meritojnë të jenë arsyeshmëri. Shembull, era kundërmuese është e domosdoshme të del nga pirja e rregullt e shumë të alkoolit, mirëpo ajo erë nuk është arsyeshmëri edhe pse ajo sillet me ndalimin e pirjes së alkoolit që do të thotë me pirjen e alkoolit paraqitet ajo erë dhe me mospirjen e alkoolit nuk paraqitet ajo erë.

Kështu pra, i jepet përparësi kijasit i cili prodhohet prej rrugës së arsyeshmërisë me harmonizim ndaj kijasit i cili prodhohet prej rrugës së prodhimit të arsyeshmërisë rotacionare.

Ka mendime të cilat janë krejtësisht të kundërta me atë çka treguam, pra i jepet përparësi arsyeshmërisë e cila është prodhuar nga harmonizimi me ligjin ndaj arsyeshmërisë së prodhuar prej detajimit dhe selektimit. I jepet përparësi asaj çka prodhohet prej rotacionit ndaj asaj çka prodhohet prej detajimit dhe selektimit ose të harmonizimit.

3. Favorizohet ajo çka fuqizohet me shenja ndaj asaj çka fuqizohet nëpërmjet rrugës së harmonizimit sepse arsyeshmëria është fuqizuar nëpërmjet rrugës tekstuale dhe ajo çka fuqizohet me tekst ka përparësi ndaj asaj çka rezultohet. Kjo veç është e qartë.

4. Favorizohet ajo çka fuqizohet me harmonizim ndaj asaj e cila llogaritet në bazë të llojit të arsyeshmërisë në llojin e ligjit ndaj asaj që llogaritet arsyeshmëri e llojit të nënllorit ligjor dhe e kundërta ose çka është nënllor i arsyeshmërisë i nënllorit të ligjit.

Pastaj favorizohet lloji i arsyes së ligjit ndaj nënllorit të arsyes së ligjit ashtu siç favorizohet ajo e cila llogaritet nënllor i arsyes në lloj të ligjit ndaj asaj që llogaritet nënllor i arsyes i nënllorit të ligjit dhe këto kuptohen nga shembujt të cilat i kemi treguar në kapitullin e kijasit.

Sa i përket pjesës së dytë është favorizimi në bazë të cilësisë së arsyes. Edhe në këtë kemi shumë lloje, të cilat Amediu i ka përkufizuar në njëzetë e nëntë sosh.

Disa dijetarë si Shevkaniu, i kanë paraparë katërmëdhjetë. Disa prej tyre i kam zgjedhur që t'i paraqes në vijim:¹⁷⁶

1. Favorizohet kijasi i arsyetuar me cilësi thelbësore, urtësia e së cilës është jo e sigurt ndaj kijasit arsyeja e së cilës është me cilësi të llogaritur, për të cilën janë pajtuar dijetarët e usulit në vlefshmërinë e arsyeshmërisë me cilësi e cila është cilësi me urtësi të pasigurt. Përderisa, për arsyeshmërinë me urtësi nuk janë pajtuar të gjithë dijetarët. Bazuar në këtë:

Favorizohet arsyeshmëria me udhëtimin, i cili mendohet se ai udhëtim sjell vështirësi me arsyeshmërinë e vet vështirësisë.

2. Favorizohet atributi vetanak ndaj atributit i cili nuk ekziston (por prodhohet) për shkak të pajtueshmërisë në të parën dhe papajtueshmërisë në të dytën.

3. Favorizohet kijasi, arsyeshmëria e të cilit është cilësi e qartë dhe e përpiktë, ndaj kijasit me cilësi të papërpiktë sepse e para është më afër mendjes për shkak të qartësisë së saj dhe pajtueshmërisë në të.

4. Favorizohet atributi unikat dhe i thjeshtë ndaj atributit të përbërë prej dy pjesëve sepse atributi vetëm prej një pjese është më i përpiktë dhe ka vlerë më të madhe në degët e ligjit dhe është më larg kundërshtimit. Përderisa arsyeja e përbërë prej dy pjesëve është e mundur që të jetë e arsyeshme në disa pjesë dhe jo në tërësi dhe paraqiten mendime të shumta. Disa dijetarë nuk e kanë lejuar këtë arsyetim.

Ky është medhhebi i shumicës dhe po ashtu njëjtë edhe te Hanefijtë.¹⁷⁷

Disa kanë thënë se arsyeshmëria e përbërë favorizohet ndaj arsyeshmërisë së thjeshtë.¹⁷⁸

5. Favorizohet ajo çka arsyetohet me arsyetim tranzitues ndaj arsyes jotranzituese sepse e para ka më shumë vlerë. Siç thotë imami i Haremejnit, kjo është e njohur. Profesori Ebu Is'hak el-Isfiraniu ka thënë: "I jepet përparësi arsyeshmërisë jotranzitore (të ngurtë) sepse ajo lidhet për tekstin e vet." Këtë mendim e ka favorizuar Gazaliu në librin e tij "El-Mustesfa".¹⁷⁹

6. Favorizohet arsyeshmëria e indikuar e cila shpie deri te ligjësimi i dispozitës ndaj arsyeshmërisë në kuptim të shenjave.

7. Favorizohet atributi i cili mendohet se sjell dobi në rast domosdoshmërie ose që i plotëson interesat e domosdoshme ndaj interesit i cili sjell dobi në rast nevojë ose që ndërlidhet me nevojat (jodomosdoshmëritë) dhe jo atyre që janë përballë saj.

Me këtë kuptohet se plotësimi i domosdoshmërive ka përparësi ndaj nevojave, plotësuesi i nevojave ka përparësi ndaj zbukurimit të nevojave. Obligohet ndalimi i alkoolit të paktë ashtu siç obligohet ndalimi i alkoolit të shumtë.

Nëse bien ndesh domosdoshmëritë atëherë shikohet çka sjellë lumturi të përgjithshme pastaj çka e siguron jetën, pastaj çka e siguron mendjen, pastaj pasardhësit dhe pastaj pasurinë.

Disa i favorizojnë këto objektiva ndaj sigurimit të fesë sepse ato janë të drejta të njeriut dhe të drejtat e njeriut bazohen në falje dhe i jepet përparësi KISASIT ndaj ekzekutimit të tradhtarit të fesë dhe vepërkryesi dorëzohet te kujdestari dhe jo te imami.

Replikohet me atë se KISASI është e drejtë e Allahut edhe pse shumica e çështjes është në të drejtën e robit sepse me dorëzimin e vepërkryerësit te kujdestari realizohen që të dy të drejtat dhe realizohen dy objektivat:

1. Objektivi i Ligjvënësit për të pastruar tokën nga shkatërrimtarët, dhe
2. Objektivi i kujdestarit për ta qetësuar atë në të drejtën e hakmarrjes.¹⁸⁰

E katërta: Favorizimi nga faktet rrethanore

Favorizimet nga faktorët rrethanor për kijasin janë po të njëjtat favorizime të cilat i kam përmendur te favorizimi i tekstit nga faktorët rrethanor, e prej tyre si në vijim:¹⁸¹

1. I jepet përparësi çka është në harmoni të bazave të arsyeshmërisë ndaj asaj që është në harmoni të bazës së arsyeshmërisë sepse nëse në njërën prej analogjive dëshmojnë shumë baza për arsyeshmërinë, ndërsa në tjetrën analogji dëshmon vetëm njëra nga ato baza, i jepet përparësi analogjisë së parë sepse të ekzistuarit e arsyeshmërisë në shumë baza dëshmon për forcën e cila parashihet në këndvështrimin e Ligjvënësit dhe në sa më shumë fakte siç kemi shpjeguar më herët.

2. I jepet përparësi kijasit çka është në harmoni me bazat të cilat janë në dispozitë ndaj kijasit çka nuk është në harmoni me bazat të cilat nuk janë në harmoni me dispozitën. Nëse njëra dispozitë e njëres analogji është dëshmuar me argumente të shumta, ose lloji i dispozitës është vërtetuar me baza të shumta, ndërsa dispozita në analogji tjetër nuk i ka ato të cilat i përmendëm, i jepet përparësi analogjisë së parë sepse dëshmia e bazave tregon për aprovimin e dispozitës prej argumenteve të shumta siç kemi treguar.

3. I jepet përparësi çka është e rregullt në ligje degëzore ndaj tjetrës e cila nuk është e rregullt. Nëse arsyeshmëria e dispozitës së njëres prej analogjive e vërteton dispozitën në të gjitha degët e asaj dispozite, ndërsa arsyeshmëria e analogjisë tjetër e vërteton dispozitën në disa pjesë (degë) dhe nuk e vërteton në disa tjera, i jepet përparësi analogjisë me arsyeshmëri të rregullt ndaj tjetrës sepse arsyeshmëria e rregullt përputhet me vlefshmërinë e arsyeshmërisë në të, përderisa, sa i përket arsyeshmërisë për të cilën janë kritikuar (nuk janë pranuar) në pranimin e asaj arsyeshmërie kanë dhënë mendime të ndryshme.

4. Favorizohet arsyeshmëria të cilës i bashkëngjitet arsyeshmëria tjetër nga ajo të cilës nuk mund t'i bashkëngjitet arsyeshmëria sepse bashkëngjitja e bën më të fortë.

5. I jepet përparësi arsyeshmërisë së cilës i bashkëngjitet fetvaja e sehabiut tek ata të cilët e pranojnë argumentimin me mendimin e sehabiut, ndaj arsyeshmërisë së cilës nuk i bashkëngjitet ai mendim.

Fusnotat:

96. “Med-hal ila medhheb Ahmed”, 196.
97. “Fusulë fi Usuli Teshrië el-Islami”, 72.
“Xhadul Mevla Sulejmanë”.
98. “Irshadul Fuhulë”, 241.
“Usulul Fikh”, 348, el-Hudrij.
“Halaf”, 273.
“Shaëban”, 302.
“Shakir el-Hanbelij”, 327.
99. “Et-Tekrirë vet-Tehbirë”, 2/3.
“Fevatihu Rahmutë”, 2/189.
“el-anavijn fil mesailul usulijeti”, 2/76.
“Usulul Istibat”, 235.
“et-Telvijh alet-Tevdijh”, 2/102.
100. Dijetarët e Usulit bëjnë dallim në mes të kundërtës dhe kontrastit.
E kundërta patjetëron zhvlerësimin me të njëjtin argument.
Kontrastja – pengon ligjësimin e ligjit edhe pse nuk ka argument kundërshtues,
mirëpo secili prej tyre në tekstualizim është e domosdoshme për njëra-tjetrën.
101. Transmetojnë dy shejhat Buhariu dhe Muslimi, dhe të tjerët nga hadithi i Usames
në këtë formulim.
Teksti i transmetimit të Buhariut: Nuk ka kamatë pos në dyfishim. (“Nejlul
Evtarë”, 5/191; “Subules-selam”, 3/37).
102. Teksti i hadithit: “grurë me grurë, i ngjashëm me të ngjashëm, dorë në dorë.”
Transmeton Buhariu.
Teksti i Muslimit: “e barabartë me të barabartë.” (“Nejlul Evtarë”, 5/190,
“Subules-selam”, 37).
103. “el-muvafekatë”.
“Sherhul Esnevi”.
“Muslimu Thubutë”.
“et-Telvijh alet-Tevdijh”.
“et-Tekrirë vet-Tehbirë”.
104. “el-muvafekatë”, 4/118.
105. “Muslimu Thubutë”, 2/152.
“Usulul Fikh”, 348, el-Hudriji.
106. “Usulul Fikh”, 274, el-Halaf.
“Irshadul Fuhulë”, 242, Shevkaniju.
“et-Telvijh alet-Tevdijh”, 2/103.
107. “el-mustesfa”, 2/126.
“Sherhul udadi ala muhtesar Ibni Haxhib”, 2/310.
“el-med-hal ila medhheb Ahmed”, 197.
“Sherhul Esnevi”, 3/182-188.

108. “Muslimu Thubutë”, 2/152.
 “Fevatihu Rahmut”, 2/189.
 “Mer’etil Usuli”, 2/372.
 “et-Tekrirë vet-Tehbirë”, 3/3.
 “et-Telviyh alet-Tevdijh”, 2/103.
 “Usulul Fikh”, 349, el-Hudrij.
 “Usulul Fikh”, 303, Shaëban.
109. E ka regjistruar Buhariu, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Ibni Maxhe nga Ibni Mes’udi.
110. Te Buhariu ekziston teksti:
- Kush e dëshiron e llogarit (bahelt-hu) se surja Nisaë është Kusra (pra suretu Talak) ka zbritur pas ajetit të suretul Bekare.
- 111.
- Te të tjerët është ndryshe:
- Kush dëshiron e llogarit (Laenet-hu). Se suretu Nisa është Kusra, e cila nuk ka zbritur pas ajeteve “pas katër muaj e dhjetë ditëve”.
112. Ibn Bezaz e ka rexhistruar në këtë mënyrë:
- kush dëshiron e llogarit (halefetet-hu) ashtu që ajeti: “Dhe shtatzënat, afati i idetit të tyre është deri sa të lirohen nga barra (lindin).” (Et-Talak : 4) është ajet i cili ka zbritur pas ajetit për gruan së cilës i ka vdekur burri dhe kur ajo të lind foshnjën. Ajo është e liruar dhe lexohet: “Dhe atyre të cilave prej juve ju kanë vdekur burrat dhe i kanë lënë gratë e tyre.” (El Bekare : 234) (Nasbu Rrajeti, 1/128).
113. Transmeton Darukutniju nga Ebi Hurejre (“Nasbu Rrajeti”, 1/128).
114. Transmeton Tirmidhiu nga Enes bin Maliku se disa njerëz nga Urejnete kanë shkuar në Medine dhe janë vendosur në një anë të Medines dhe pejgamberi s.a.v.s. u ka dërguar deve sadaka dhe u ka thënë: Pini nga qumështi dhe urina e tyre.
 “Xhamiul usul”, 8/332.
115. “Muslimu Thubutë”, 2/153.
 “et-Tekrirë vet-Tehbirë”, 3/5.
116. “Muslimu Thubutë”.
 “Fevatihu Rahmut”, 2/194.
 “et-Tekrirë vet-Tehbirë”, 3/4.
117. Me fjalën “ndarja e drejtimit” kanë për qëllim, ana e deklarimit (vërtetimit) nuk është e njëjtë me anën e mohimit, si p.sh., thënia e Zotit të Lartmadhëruar: “Dhe nuk ke gjuajtur kur ke gjuajtur, por (në realitet) Allahu ka gjuajtur.” (El-Enfal : 17) E para e mohon gjuajtjen, e dyta e vërteton gjuajtjen. Atëherë të parësi i jepet kuptimi se gjuajtja nuk ka pasur kurrfarë ndikimi dhe e gjithë ushtria ka qenë në tokë, përdërisa të dytës i jepet kuptimi i gjuajtjes faktike, e gjuajtjes.
118. Transmeton Muslimi nga Zejd bin Halid bin el-Xhehniju (“Subulus-Selam”, 4/126).
119. Muttefikun alejhi mes të Buhariut dhe Muslimit nga Imran bin Husejini.

120. E ka regjistruar Ebu Davudi dhe Nesaiu nga Abdullah bin Asi. Me këtë veprojnë hanefijtë (“Nashu Rrajeti”, 2/227; “Subules-selam”, 2/76).
121. E kanë regjistruar gjashtë koleksionistët në librat e tyre nga Aishja. Me këtë veprojnë shumica absolute e fukahave (“Nasbu Rrajeti”, 2/225; “Subules-Selam”, 2/73-75).
122. “Usulul fikhi Islam”, 306, prof. Zekijudijn Shaëban.
“et-Telvijh alet-Tevdijh”, 2/104.
123. “Muslimu Thubutë”, 2/152.
124. “Muslimu Thubutë”, 2/153.
“Fevatihu Rahmutë”, 2/193.
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë”, 3/3.
“Usulul Fikh”, 349, el-Hudrij.
125. “el-mustesfa”, 2/126.
126. “Usulul Fikh”, 350.
127. “Sherhul mehalij ve Hashijetul Benani ala Xhemil Xhevamiu”, 2/295.
“Risaletu fi usuli Dhahirije”, 32.
“Risaletu fi usuli fikh”, 77, es-Sujutiu.
“el-mustesfa”, 2/127.
“Sherhul udadi ala muhtesar Ibni Haxhib”, 2/310.
“Sherhul Esnevi”, 3/192.
“Irshadul Fuhulë”, 227.
“el-med-hal ila medhhebi Ahmed”, 197.
“Revdatu Nadhir”, 2/457.
Në librin “el-med-hal ila medhhebi Ahmed” Ibn Bedrani ka thënë: Nëse dy tekste ndeshen në mes vete ose dihet historiku i tyre ose nuk dihet. Nëse nuk dihet i japim përparësi njëres prej tyre në bazë të prioriteteve. Nëse dihet historiku i tyre, ose mund të bëhet pikëbashkimi i tyre ose jo.
Nëse bëhet pikëbashkimi, atëherë legjislativisht duhet të bëhet bashkimi në bazë të mundësive.
Nëse nuk mund të bëhet bashkimi i tyre, atëherë e dyta është shfuqizues nëse zinxhiri i tyre është i drejtë, ose përndryshe njëri prej tyre është përgënjeshttrim nëse senedi (zinxhiri) nuk është i drejtë, sepse nuk mund të ketë kundërshtim në mes të dy argumenteve të sheriatit sepse Ligjvënësi është i urtë, ndërsa kundërthënia është e kundërta e urtësisë.
128. “Sherhul Esnevi”.
“Mudhekerat fi usulil fikh”, 199, shejh Zehirë.
129. Ibn Xhevziu këtë hadith e ka gjykuar si të fabrikuar.
Ibn Haxheri ka thënë: Hadithi është meshhurë dhe zinxhirin nuk e ka të fortë.
Abdul Hak ka thënë: Hadithi është i dobët dhe është saktësuar nga thënia e Aliut.
(“Esnel metalibu fi ehadith muhtelifetul meratib”, 257, el-Bejruniu).
130. Ai i cili nuk është falur me pejgamberin s.a.v.s., atij pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë (ashtu siç transmeton Ahmedi dhe autorët e suneneve, përpos Maxhez nga Jezij bin Esvedi): Nëse jeni falur në mjetin tuaj transportues, pastaj shkoni në xhami ku

- falet namazi me xhematë. Faluni me to, sepse për ju ai namaz do të jetë nafile (vullnetare). ("Nejlul Evtarë", 3/128; "Subules-Selam", 1/21).
131. "Ilmi Usulul fikhi", 276, Halafi.
 132. "Sherhul Udadi ala muhtesar", Ibni Haxhibi, 2/309.
"el-Ihkam", 3/174, el-Amediu.
 133. "Muslimu Thubutë", 2/161-165.
"et-Telvijh alet-Tevdijh", 2/103.
"Keshful Esrarë", 1/1198.
"Usulul Fikh", 355, el-Hudriji.
"Sherhul Esnevi", 3/198.
 134. "Sherhul Esnevi", 3/189.
 135. Transmeton Ahmedi, Muslimi, e ka saktësuar Tirmidhiu nga Aishja r.a. në formulimin: Nëse e prekin dy organet intime njëri-tjetrit, gusuli bëhet obligim.
 136. Transmeton Muslimi; bazën e ka te Buhariu nga Ebi Seid el-Hudriji ("Subules-Selam", 1/85).
 137. Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Aishja r.a. dhe Umi Selmete se pejgamberi s.a.v.s. është zgjuar në mëngjes i papastër nga kontakti intim, pastaj ka marrë gusul dhe e ka vazhduar agjërimin. ("Subules-selam", 2/165).
 138. E ka regjistruar Ahmedi dhe Ibni Habani nga hadithi i Ebi Hurejres r.a. ("Subules-Selam").
 139. Tregimin e transmeton Ahmedi dhe autorët e suneneve, përpos Nesaijut nga Kajsete bin Dhuejbi ("Nejlul Evtarë", 6/59).
 140. Është hadithi: Nëse ndonjëri nga ju kërkon leje tri herë dhe nuk merr përgjigje, le të kthehet. Transmeton Maliku, Ahmedi, Buhariu, Muslimi dhe Ebu Davudi, nga Ebi Musa dhe Ebu Seidi.
 141. "el-Ihkam", 3/174, el-Amediu.
"el-mustesfa", 2/127.
"Keshful Esrarë", 2/1196.
"Muslimu Thubutë", 2/160.
 142. "Muslimu Thubutë", 3/176.
 143. "Irshadul Fuhul", 244.
 144. "el-Amediu".
"el-mustesfa".
"Irshadul Fuhulë".
"Muslimu Thubutë".
"Sherhul Esnevi".
"Sherhul Udadi ala muhtesar", Ibni Haxhib.
"el-med-hal ila medhhebi Ahmed".
"Revdatu Nadhir".
"Tehrixhil furuë alel usulë".
 145. "Keshful Esrarë".
"et-tekrirë vet-tehbire".
"et-Telvijh alet-Tevdijh".
"Fevatihu Rahmutë".

“Muslimu Thubutë”.

Kanë thënë: E shumta nëse sjell rezultatin e shumicës prapëseprapë, ajo është vetëm një atribut i cili e forcon lajmin, e cila është meritore për prioritet sepse ajo e cila e bën prioritare është forca e përparësisë dhe jo e shumta.

“Muslimu Thubutë”.

146. “el-Ihkam”, 3/176, el-Amediu.

“Sherhul Esnevi”.

“Sherhul udadi ala muhtesar Ibni Haxhib”.

“el-med-hal ila medhhebi Ahmed”.

“Revdatu Nadhir”.

“et-Telvijh alet-Tevdijh”.

“Usulul fikhi”, 332, Shakir el-Hanbelij.

147. “el-Amediu”, 3/178.

148. “el-Amediu”, 3/179.

149. “el-Ihkam lil-Amedi”, 3/180.

150. E përgjithshmja dhe e veçanta e papërcaktuar: Është atëherë kur edhe e përgjithshmja edhe e veçanta janë një çështje, e pastaj e përgjithshmja veçohet nga e veçanta në një çështje tjetër, shembull, gjallesa dhe njeriu, këta të dyja bashkohen në Zejdin, e pastaj gjallesa veçohet te kali.

Përderisa e përgjithshmja dhe e veçanta drejtimore: Është atëherë kur e veçanta dhe e përgjithshmja bashkohen në një çështje dhe secila prej tyre veçohet nga njëra-tjetra në çështje tjetër, shembull, njeriu dhe e bardha, që të dyja bashkohen te njeriu i bardhë, e pastaj njeriu veçohet tek njeriu i zi dhe e bardha veçohet tek guri i bardhë.

151. Janë pesë kohët.

Pas namazit të sabahut deri sa të lind dielli.

Pas ikindisë deri sa të perëndon dielli.

Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebi Seid el Hudriju. Dhe në lindjen e diellit deri sa të ngrihet dielli pak dhe në kohën e zenitit në kohën e drekës, dhe pas perëndimit të diellit. Transmeton Muslimi nga Ukbete bin Amiri. (“Subules-Selam”, 1/111)

152. “Sherhul Esnevi”, 3/195.

“Irshadul Fuhulë”, 247.

“Mudhekeratë fi usulul fikh”, 203, prof. Zekiri.

153. “el-Amediu”.

“Irshadul Fuhulë”, 245.

“Muslimu Thubutë”, 2/121.

“et-Telvijh alet-Tevdijh”, 2/400.

“Sherhul Esnevi”, 3/212.

“Sherhul Udadi ala muhtesar muntehi”, 3/2.

“el-med-hal ila Medhheb Ahmed”, 197.

154. “Irshadul Fuhulë”, 246.

155. “el-Ihkam”, 3/185.

156. Ibid.
 “Sherhul udadi ala Muhtesar Ibni Haxhib”, 2/315.
 “et-Telviyh alet-Tevdihë”, 2/108.
 “Sherhul Esnevi”, 3/212.
 “Muslimu Thubutë”.
 “el-mustesfa”.
 “Mudhekeratë fi usulil fikh”, 213, prof. Zehirë.
157. E ka dobësuar Bejhekiu.
 E ka regjistruar Abdurr-Rrezaku si hadithë mevkufë nga Ibni Mes’udi.
 Zejleiju e përmend si hadithë merfuë.
 Gazaliu thotë se nuk ka bazë. (“el-eshbahu ven-nedhair”, 1/144, Ibni Nexhimi;
 “Nesbu Rrajeti”, 4/314).
158. Po ashtu ky hadithë tregon për favorizimin e argumentit të prerë ndaj atij jo të prerë.
159. “Sherhul Esnevi”, 3/217.
 “el-Ihkam”, 3/185.
 “Sherhul Udadi muhtesar el-muntehi”, 2/315.
160. Transmeton Buhariu, 2/293.
161. Transmeton Ahmedi, Muslimi dhe Nesaiu. (“Xhem’ul fevaid”, 1/485; “Nejlul Evtarë”, 5/85).
162. Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ibni Abasi (“Subules-Selam”, 3/134;
 “Nejlul Evtarë”, 5/14).
163. Transmeton Maliku në Muvetaë. Hadithi i martesës me Mejmunen ka qenë para se të dilte nga qyteti i Medines. Kjo nga Sulejman bin Jesari.
 Ibn Tejmiye thotë: Kjo dëshmon se martesa me të ka qenë para ihramit të cilën gjë nuk e ka ditur Ibni Abasi.
 Seid bin Musejeb ka thënë: Ibn Abasi ka menduar se është martuar me Mejmunen deri sa ka qenë në ihram. (“Nejlul Evtarë”, 5/14, 269).
 Transmeton Muslimi nga Mejmuneja se pejgamberi s.a.v.s. është martuar me Mejmunen, pasi që është liruar prej Ihramit. (“Subules-Selam”, 3/124).
164. “Muslimu Thubutë”, 2/162.
 “et-Telviyh alet-Tevdijh”, 2/109.
 “Irshadul Fuhulë”, 246.
 “el-mustesfa”, 2/129.
 “el-ihkam”, 3/186, el-Amediu.
165. “Usulul Fikhi”, 353, el-Hudriji.
166. “El-Ihkam”, 3/187, el-Amediu.
 “Sherhul Esnevi”, 3/217.
 “Muslimu Thubutë”, 2/216.
 “Irshadul Fuhulë”, 346.
167. Hadithi është mevkuf te Ibn Mes’udi dhe Umeri.
 Në musned është si merfuë nga Ibn Abasi sipas Ebu Hanifes.
 Transmetohet me zinxhirë të dobët në formulim tjetër nga Aishja: Dënimeve të prera te muslimanët largojuni sa më shumë. (“Nasbu Rrajeti”, 3/309-323; “Nejlul

- Evtarë”, 7/104; “Fejdule Kadirë”, /327).
- Në saktësimin e Dhehebiut, te Bejhekiu në lajmin e Aishes qëndron formulimi:
Largohuni sa më shumë dënimeve të prera dhe ekzekutimeve.
168. “el-mustesfa”, 2/129.
169. “el-Ihkam”, 3/187, el-Amediu.
“Sherhul Esnevi”.
“Muslimu Thubutë”.
“Irshadul Fuhulë”.
170. “el-Ihkam”, 3/187, el-Amediu.
“Sherhul Esnevi”.
“Muslimu Thubutë”.
“Irshadul Fuhulë”.
171. Transmeton Buhariu dhe Muslimi në formulimin e parë: Shpërblimi i jetës,
varësisht prej aftësisë dhe mundësive.
Formulimi i dytë: Por ajo është në masë të nevojave apo furnizimit.
172. “Irshadul Fuhulë”, 247.
173. “el-ihkam fi usulul Ahkam”, 3/188.
“Sherhul Esnevi”, 3/218.
“Muslimu Thubutë”, 2/62.
174. “el-Ihkam fi usulil ehkam”, 3/190.
175. “Sherhul Esnevi”, 3/230.
“Irshadul Fuhulë”, 239.
176. “el-mustesfa”, 2/130.
“Sherhul udadi ala muhtesar Ibni Haxhib”, 2/315.
177. “el-Ihkam”, 3/197, el-Amediu”, 3/197.
“Irshadul Fuhulë”, 250.
“Muslimu Thubutë”, 334.
“Usulul Fikh”, 327, el-Hudriji.
178. “el-Ihkam”, 3/192, el-Amediu.
“el-mustesfa”, 2/130, el-Gazaliu.
“Irshadul Fuhulë”.
“Muslimu Thubutë”.
“Sherhul Esnevi”.
“Sherhul udadi ala muhtesar Ibni Haxhib”.
“el-med-hal ila medhheb Ahmed”.
“Usulul fikh”.
179. Ibid.
“el-Ihkam”, 3/193, el-Amediu.
“Irsadhul Fuhulë”, 348.
180. “Muslimu Thubutë”.
181. “Irshadul Fuhulë”, 248.
182. “el-mustesfa”, 2/132.
183. “Muslimu Thubutë”, 2/283.
“Sherhul Esnevi”, 3/227.

184. “Muslimu Thubutë”, 2/286.
“et-Telviyh alet-Tevdijh”, 2/211.
“Keshful Esrarë”, 2/1215.
“Sherhul Esnevi”, 3/231.
“Irshadul Fuhulë”, 250.
“el-Ihkam”, 3/197, el-Amediu.
“el-mustesfa”, 2/130-132.
“Mudhekeratë fi usulul fikhi”, 230, prof. Zehirë.

Përmbajtja:

<i>Hyrje</i>	5
<i>Tema e parë: Kundërshtimi në mes argumenteve</i>	7
Esenca dhe sfera e kundërshtimeve	8
Sfera e kundërshtimeve	10
Dispozita e kundërshtimeve apo mënyra e tejkalimit të kundërshtimeve	11
E para: Rruga e Hanefijëve	11
E dyta: Rruga e Shafijëve në mënjanimin e kundërshtimeve	19
<i>Tema e dytë: Favorizimi i argumenteve</i>	22
Definicioni i favorizimit dhe argumentet të cilat veprojnë për të favorizuar	23
Rrugët e favorizimit	26
Favorizimi në mes teksteve	26
E para: Favorizimi në bazë të zinxhirit	27
E dyta: Transmetimi nga aspekti i tekstit	30
E treta: Favorizimi nga aspekti i gjykimit (dispozita) apo tregueshmërisë	33
E katërta: Favorizimi nga çështjet rrethanore	37
Favorizimi pas krahasimeve	39
E para: Favorizimi nga aspekti i bazës	39
E dyta: Favorizimi nga aspekti i degës	41
E treta: Favorizimi në bazë të arsyeshmërisë	42
E katërta: Favorizimi nga faktet rrethanore	46